



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Rrjeti i Grave të Kosovës shënon Kuvendin e 15-të të Anëtareve

Këtë të shtunë, me datë 16 dhjetor 2017, [Rrjeti i Grave të Kosovës \(RrGK\)](#) organizon Kuvendin e 15-të me radhë të Anëtareve. RrGK ka punuar në arritjen e vizionit të saj që të bëjë Kosovën një vend ku gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta në arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, shëndetësi, dhe bëjnë një jetë pa dhunë.

Vizionin e saj, RrGK e arrin përmes misionit të saj që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, moshë, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGK e realizon këtë mision përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve.

Kuvendi i Anëtareve të RrGK-së përbëhet nga 125 organizata të shoqërisë civile të udhëhequra nga gratë dhe që kanë për qëllim arritjen e barazisë gjinore në Kosovë. RrGK momentalisht është duke vepruar bazuar në [Strategjinë e saj për periudhën 2015 – 2018](#), e cila është e ndarë në 5 fusha: 1. Ngritja e kapaciteteve të RrGK-së; 2. Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje; 3. Shëndeti i Grave dhe Vajzave; 4. Dhuna në Baza Gjinore dhe 5. Fuqizimi Ekonomik i Grave.

Në këtë Kuvend Vjetor të Anëtareve, RrGK do të festojë bashkë me anëtarët e saj dhe të gjithë miqtë e përkrahësit e saj, disa nga të arriturat kryesore të RrGK gjatë vitit 2017.

**Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve** të organizatave anëtare, RrGK nga viti 2012 ka krijuar Fondin e Grave të Kosovës (FGK), ku gjatë këtij viti përmes tij është mundësuar zhvillimi i 145 iniciativave avokuese në fusha të ndryshme, bazuar në Strategjinë e RrGK-së. Janë dhënë gjithsej 27 grante prej të cilave kanë përfituar 31 organizata anëtare, ndërsa 4,413 persona kanë përfituar nga projektet e përkrahura nga FGK. Mbi 564 gra u angazhuan në proceset vendimmarrëse përmes këtij fondi. Në këtë vit, FGK në total ka ndarë 99,842 € për organizatat anëtare, ku 43,408 € ishin nga Austrian Development Agency (ADA) dhe 56,434 € nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë. RrGK ka krijuar dokumente të politikave dhe ka avokuar në Bruksel për mënyra më të mira të financimit për organizatat e udhëhequra nga gratë në rajon.

**Drejt përmirësimit të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje**, Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë, vazhdoi ndërmarrjen e iniciativave avokuese në 26 komuna, duke rezultuar në 13 ndryshime të politikave. Poashtu, RrGK ka vazhduar të ofrojë mbështetje teknike për delegacionin e BE-së dhe Ministrinë për Integritet Evropian në përfshirjen e perspektivës gjinore në programet e Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA) në Kosovë, përfshirë fazat e planifikimit dhe zbatimit. Si pjesë e kësaj, RrGK ka mbështetur gjithashtu zhvillimin e Planit të Veprimtari Gjinore të delegacionit të BE-së për vitin 2016-2020 në Kosovë. Tutje, RrGK ka dhënë kontribut nga një perspektivë gjinore në raportet e progresit, Agjendën e Reformës Evropiane, dialogun politik dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit në Kosovë.

Me synim të arritjes së Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor, në bazë të mbështetjes që RrGK ka ofruar për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Diasporës në përfshirjen e një perspektive gjinore në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, të dy Ministrinë kanë integruar të gjitha ndryshimet e propozuara nga RrGK në këtë dokument të rëndësishëm buxhetor. Më tutje, RrGK gjatë 2017, ka publikuar raportet [Buxhetimi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural më të Mirë](#) dhe [Buxhetimi për Përmirësimin e Barazisë Gjinore në Programet për Diasporën](#).

**Drejt përmirësimit të qasjes së grave dhe vajzave në shërbime kualitative shëndetësore**, këtë vit, RrGK publikoi hulumtimin e parë në Kosovë mbi qasjen në kujdesin shëndetësor, të titulluar "[Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë](#)." Gjatë këtij viti, përmes [Koalicionit K10](#) për Shëndet dhe të Drejta Riprodhuese, ku anëtar është edhe RrGK, u krijua strategjia tri vjeçare e këtij koalicioni, si dhe u organizuan disa diskutime publike mbi shëndetin dhe të drejtat riprodhuese.

**Në përpjekjet e saj për adresimin e dhunës në baza gjinore,** RrGK gjatë këtij viti ka zhvilluar iniciativa të ndryshme avokuese dhe takime me zyrtarë me qëllim të dërgimit të rekomandimeve të hulumtimit “[Mjaftë më me arsytimit](#)” dhe “[Ngacmimi Seksual në Kosovë](#)”. Poashtu, RrGK gjatë këtij viti përkrahu familjen e të ndjerës Z.B., me rastin e denimit të ulët të vrasësit të saj Nebih Berisha, ku pas ankesës së pregatitur nga përfaqësuesja ligjore e angazhuar nga RrGK, ai nga denimi fillestar prej 12 vjetësh, me vendim të Gjykatës së Apelit, u dënua me 17 vjet burgim. Po këtë vit, RrGK filloi bashkëpunimin me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, ku së bashku monitoruam punën e institucioneve gjatë trajtimit të rasteve të dhunës me baza gjinore. Raporti final do të bëhet publik në fillim të vitit 2018. Në të njëjtën kohë, RrGK ka dërguar rekomandimet e saj tek grupi punues mbi Ndryshim/Plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku u rekomandua që dhuna në familje dhe ngacmimi seksual të definohen si vepra kriminale në Kodin Penal.

Gjatë vitit 2017, RrGK kontribuoi në fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës, ku ndau në total 180,487 € për katër organizatat anëtare të RrGK-së të specializuara në punën me këto gra. Pastaj, këto organizata ndanë mikro-grante për 177 gra të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe ofruan përkrahje psikologjike. Anëtarët e RrGK kanë bashkëpunuar në avokim për çështjen aprovimit të buxhetit nga Qeveria e Kosovës, për reparacionet për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës.

**Për të kontribuar në fushën e fuqizimit ekonomik të grave,** gjatë 2017, është themeluar Forumi Ekonomik i Grave dhe është përfshirë në Këshillin Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës. RrGK si bashkëthemeluese e këtij forumi, ka ndërmarrë hapa drejt krijimit të një strategjie avokuese të përgjithshme e cila e ka si synim përmirësimin e disa politikave kyçe për punësimin e grave në Kosovë.

RrGK ka hulumtuar dhe shkruar një vlerësim të pavarur mbi implementimin e Planit të Veprimit Gjinor 2016 - 2020 (GAP II) të BE në vendet e rajonit dhe në Kosovë, të cilin do ta prezantojë në Bruksel gjatë vitit 2018. Poashtu, kemi krijuar një Strategji për Integrimin e Përspektives Gjinore në Proceset e Anëtarësimit të Kosovës në BE që do të shërbejë për avokimin e RrGK në të ardhmen.

Këtë vit RrGK ka pasur përkrahje financiare nga UN Women, ADA, Zyra e BE në Kosovë, Kvinna till Kvinna Foundation, Swiss Contact, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Heart and Hand Foundation, anëtarët e RrGK dhe donatorët individual.